



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË**

**KOMISIONI I HARTIMIT TE DOKUMENTAVE TE TENDERIT**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Himarë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2026

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-SHËRBIME**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT “Organizimi i Aktivitetit te Celjes se sezonit veror 2026”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbime të organizimit të eventeve kulturore 79952100-3

VLERA E FONDIT : 9,800,000 (nente milione e teteqind mije) leke pa tvsh

**Perllogaritja e fondit limit** dhe specifikimeve teknike eshte kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik*

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale**

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit (shtojca 7)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025** lëshuar nga administrata tatimore , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojme qe operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten”, ”Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë,

*OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.
- Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ”Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2024** dhe **2025** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti

për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqitet kontrata e lidhur e shoqëruar me vërtetimin përkatës të lëshuar nga enti publik për realizimin e suksesshëm të kontratës.

#### Ose

- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 20% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur

duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

*\* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licënsave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

2.3.2 Një punësim mesatar i të paktën **20 (njëzetë) personave** të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar.

*Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.*

**Argumentimi :** Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 20 (njetete) punonjës **punonjës** punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, me koë të plotë pune është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë,drejtuesit e mjeteve të thjeshta etj., duke pasur parasysh njëkohësisht kohen e shkurter te realizimit. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj eshte kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Përlllogaritja e numrit total të punonjësve është bërë në bazë të aktiviteteve te shumeta qe do te zhvillohen ne keto dite te zbatimit te kontrates.

2.3.3 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf të specializuar, për realizimin e kësaj kontrate, si më poshtë:

- Minimumi 1 (nje) Teknik Audio i certifikuar
- Minimumi 1 (nje) Elektracist per instalime i certifikuar
- Minimumi 1 (një) Teknik Video i certifikuar
- Minimumi 1 (nje) IT i certifikuar
- Minimumi 1 nje menaxher projektesh, për mbajtjen e marrëdhënieve me autoritetin kontraktor dhe monitorimin e vazhdueshem të projektit deri në zbatimin e plotë të tij

*Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10-të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Kërkesat për disponueshmërinë e stafit të specializuar janë vendosur në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe specifikat teknike të kontratës, me qëllim garantimin e një realizimi cilësor, të sigurt dhe në përputhje me standardet përkatëse.

- Teknik Audio i certifikuar (min. 1)

Prania e një tekniku audio të certifikuar është e domosdoshme për instalimin, konfigurimin dhe testimin korrekt të pajisjeve audio. Ky rol garanton cilësinë e transmetimit të zërit, shmangien e ndërhyrjeve teknike dhe optimizimin e performancës së sistemit në përputhje me parametrat teknikë të kërkuar.

- Elektracist për instalime i certifikuar (min. 1)

Duke qenë se projekti përfshin instalime elektrike dhe furnizim me energji për pajisje të ndryshme, kërkohet një elektracist i certifikuar për të garantuar realizimin e instalimeve në përputhje me normat e sigurisë elektrike, parandalimin e rreziqeve dhe funksionimin e qëndrueshëm të sistemit.

- Teknik Video i certifikuar (min. 1)

Ky profil është i nevojshëm për instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve video, duke siguruar cilësi të lartë të transmetimit vizual, integrim të plotë me sistemet ekzistuese dhe funksionim të pandërprerë të tyre.

- IT i certifikuar (min. 1)

Për shkak të komponentëve digjitalë dhe të rrjetit që përfshin projekti, kërkohet një specialist IT i certifikuar për konfigurimin e sistemeve, sigurinë e rrjetit, integrimin e pajisjeve dhe zgjidhjen e problematikave teknike që mund të lindin gjatë implementimit dhe operimit.

- Menaxher projektsh (min. 1)

Për të siguruar koordinimin efektiv të të gjitha fazave të projektit, komunikimin e vazhdueshëm me autoritetin kontraktor dhe monitorimin e progresit deri në përfundimin e plotë të kontratës, kërkohet një menaxher projektsh. Ky rol garanton respektimin e afateve, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e zbatimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë **1(një)** punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM-se Nr. 312, dt 05.05.2010 "Për sigurinë në kantier", VKM-së Nr.108, dt 09.02.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1.a dhe 1.b, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, Libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

**Argumentimi:** Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën **1 (një)** punonjës të pajisur me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" është vendosur në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht Ligjin Nr. 10327, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", si dhe aktet nënligjore përkatëse (VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 dhe VKM Nr. 108, datë 09.02.2011).

Kjo kërkesë është e domosdoshme duke marrë në konsideratë natyrën e kontratës, e cila përfshin procese instalimi, përdorim pajisjesh teknike dhe ndërhyrje në terren, të cilat paraqesin rreziqe potenciale për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve dhe palëve të treta.

Prania e një specialisti të certifikuar në këtë fushë garanton:

Zbatimin korrekt të rregullave dhe procedurave të sigurisë në punë gjatë gjithë fazave të projektit;

Identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve të mundshme në ambientet e punës;

Hartimin dhe ndjekjen e masave parandaluese për shmangien e aksidenteve dhe incidenteve;

Sigurimin e përputhshmërisë me standardet ligjore dhe teknike në fuqi;

Monitorimin e vazhdueshëm të kushteve të punës dhe ndërhyrjen në kohë në rast problematikash.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit përkatës (kontratë pune e vlefshme, diplomë/certifikatë, librezë pune dhe evidencë në listpagesat e E-Sig për të paktën 3 muajt e fundit) synon të vërtetojë marrëdhënien reale të punësimit dhe disponueshmërinë efektive të këtij specialisti gjatë zbatimit të kontratës, duke shmangur deklaratimet formale dhe duke garantuar kapacitetin real të operatorit ekonomik.

**2.3.5 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të ketë certifikata cilesie në gjuhën shqipe, ose të perkthyerat dhe të noterizuara si më poshtë:**

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, në fushën e veprimtarisë që konkuron, sipas standardit ndërkombëtar **EN- ISO 9001-2015** (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalente të saj. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 45001-2018**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 27001-2022**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mesiperme sipas natyrës së punimeve

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020“Për prokurimin publik” dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, të ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo certifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë

punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 45001:2018: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikën, procedurat dhe kontrollin e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

- Per ISO 27001-2022 “Per sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit”

Certifikata ISO 27001:2002 garanton që organizata ka zbatuar masa të përshtatshme për të mbrojtur informacionin e ndjeshëm nga rreziqet e brendshme dhe të jashtme. Kjo ndihmon në ruajtjen e të dhënave kundër aksesit të paautorizuar, humbjes apo modifikimit të paqëllimtë.

**2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet, makineritë dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;**

| Mjetet                            | Sasia  | Gjendja             |
|-----------------------------------|--------|---------------------|
| Automjet transporti deri në 3.5 T | 2 copë | Pronësi ose me qira |
| Automjet Transporti mbi 7.5 T     | 2 cope | Pronësi ose me qira |
| Gjenerator AC (min 350 KË)        | 1 cope | Pronësi ose me qira |

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- **Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike** duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe foto e dukshme të mjetit.
- 2- **Për mjetet e siguruar me qira**, të paraqitet kontrata e lidhur për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e

mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.

- 3- **Për pajisjet/ makineritë në pronësi** të shoqërohen me Akt - Pronësie original ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 4- **Për pajisjet/ makineritë me qera** të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie original ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të shërbimeve janë të nevojshme për realizimin e shërbimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e shërbimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

- Automjet transporti deri në 3.5 T (min. 2 copë)

Këto automjete janë të nevojshme për transportin e pajisjeve më të lehta, materialeve ndihmëse dhe stafit teknik në terren. Prania e të paktën dy mjeteve të tilla siguron fleksibilitet operacional dhe mundëson zhvillimin paralel të proceseve të ndryshme të instalimit pa vonesa.

- Automjet transporti mbi 7.5 T (min. 2 copë)

Për transportin e pajisjeve të rënda dhe voluminoze kërkohen mjete me kapacitet të lartë mbajtës. Këto automjete garantojnë lëvizjen e sigurt dhe efikase të komponentëve kryesorë të projektit, duke shmangur dëmtimet dhe duke optimizuar kohën e dorëzimit dhe instalimit.

- Gjenerator AC (min. 350 KË) (min. 1 copë)

Duke qenë se projekti mund të kërkojë furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike gjatë instalimeve apo operimit të pajisjeve në terren, një gjenerator me kapacitet minimal 350 KË është i domosdoshëm për të garantuar vazhdimësinë e punës edhe në mungesë ose

paqëndrueshmëri të rrjetit elektrik. Ky element është kritik për shmangien e ndërprerjeve dhe për sigurimin e funksionimit të pandërprerë të sistemeve.

Kërkesa që këto mjete të jenë në pronësi ose me qira, e vërtetuar përmes dokumentacionit përkatës, synon të garantojë që operatori ekonomik ka realisht në dispozicion kapacitetet e nevojshme logjistike për zbatimin e kontratës, duke shmangur pengesat që mund të lindin nga mungesa e mjeteve gjatë implementimit.

## **NJESIA E PROKURIMIT**